



REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS  
Nr. Njes: 01 Shënja klas.: 96  
Nr. Prot/Viti: 1391/2024  
Data: 13.03.2024  
Prishtine

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /  
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr.35/2024

Datë:11.03.2024

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës në mbështetje të neneve 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, bazuar në Rregulloren (QRK) NR.14/2023 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke u mbështetur ne nenin 4 te Ligjit Nr.02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, Rregulloren Nr. 11/2022 për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes se trashëgimisë kulturore për mbrojtje, si dhe duke marre për bazë propozimin e Kryetares së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me numë të protokollit 1203/2024 të datës 05.03.2024, mori këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Lista e aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të përhershme, sipas propozimeve të shqyrtuara nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore për përfshirje të këtyre aseteve në Listën e aseteve me status të mbrojtjes së përhershme.
2. Lista e aprovuar si në pikën një ( 1 ) te këtij Vendimi, përfshin 11 ( njëmbëdhjete) asete të trashëgimisë kulturore si në vijim:
  - 2.1. Tuma e Shpenadisë - Prizren;
  - 2.2. Tuma e Gjinocit - Suharekë;
  - 2.3. Vendbanimi Shumështresor i Topanicës - Kamenicë;
  - 2.4. Vendbanimi prehistorik i Hisarit - Suharekë;
  - 2.5. Sahat Kulla dhe Muzeu Arkologjik - Prizren;
  - 2.6. Shtëpia e familjes Pomaku - Prizren;
  - 2.7. Kroi i Beledinjës - Prizren - Prizren;
  - 2.8. Shtëpia e Adem Aga Gjonit - Prizren;
  - 2.9. Shtëpia e Zekirja Sokolit - Prizren;
  - 2.10.Ndërtesa e Kuvendit të Vjetër - Beledije – Prizren;
  - 2.11.Kompleksi i Sarajit të Vjetër - Prizren.

3. Këtij Vendimi i bashkëngjitet edhe Lista origjinale me numër të protokollit 1292/2024 i datës 08.03.2024 e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij Vendimi .
4. Ky vendim hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

*Vendimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;*
- *Komunës së Prizrenit;*
- *Komunës së Suharekës;*
- *Komunës së Kamenicës;*
- *Inspektoratit për Trashëgimi Kulturor;*
- *Departamentit për Trashëgimi Kulturor;*
- *Institucioneve të Trashëgimisë Kulturorë;*
- *QRTK - ve përkatëse;*
- *Agjencionit Kadastral të Kosovës*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MKRS-së.*

